

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6933
E shtunë, 1 korrik 2023
Çmimi 0.40

Hovenier: Qeveria e Kosovës po na habit me refuzimin e kërkesave të miqve të saj



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LIDERËT E BE-së KËRKOJNË SHTENSIONIM NË KOSOVË, PARALAJMËROJNË PASOJA

FAQE 4-5



Udhëheqësit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian kanë bërë thirrje të premtën për shtensionim të menjëhershëm të situatës në veri të Kosovës, ndërsa kanë paralajmëruar pasoja në rast

të dështimit. Në tekstin e Këshillit Evropian theksohet se zgjidhja e problemeve duhet bërë në bazë të rekomandimeve të 3 qershorit të BE-së që përfshijnë pezullimin e operacioneve policore, që


kryetarët e komunave t'i kryejnë përkohësisht detyrat e tyre në objekte të tjera, shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme dhe pjesëmarrjen e serbëve në këto zgjedhje

DIPLOMOI GJENERATA E 15 E KADETËVE TË FSK-së, KOSOVA PO FORCON USHTRINË

FAQE 3



MOSKOMPENSIMI I DËMEVE NGA VËRSHIMET FALIMENTON BIZNESE



AKTUALE



NË SPITALIN E PRIZRENIT PËR HERË TË PARË FILLON SHPËRNDARJA E TERAPISË TABLETARE ONKOLOGJIKE

F. 6

KUVENDI KOMUNAL I GJILANIT E SHKARKON KRYESUESIN ARIANIT SADIKU

F. 6

LISTA SERBE, PAS VENDIMIT PËR SHPALLJEN E ORGANIZATAVE TERRORISTE: KFOR-I DHE EULEX-I TA PENGOJNË PLANIN E KURTIT

F. 3

EKONOMI



QEVERIA MIRATON AGJENDËN DIGJITALE TË KOSOVËS 2030

F. 7

SPORT



DUKA SËRISH NË KE TË UEFA-SË, MERR PËRSIPËR PËRKUJDESJEN NDAJ FFK-së

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kryeministri suedez kërkon qetësi dhe reflektim pas djegies së Kuranit

STOKHOLM, 30 QERSHOR - Kryeministri i Suedisë, Ulf Kristersson, u distanca nga protesta e kësaj jave në të cilën një irakian me banim në Suedi dogji librin e shenjtë të myslimanëve, Kuranin, jashtë një xhamie në Stokholm.

Djegia e Kuranit shkaktoi zemërim në pjesë të botës myslimane. “Është e vështirë të thuash se cilat do të jenë pasojat. Mendoj se ka shumë njerëz që kanë arsye të reflektojnë”, tha Kristersson në një konferencë për medie. “Kjo është një pyetje serioze sigurie. Nuk ka nevojë të ofendohen njerëzit e tjerë”, ka shtuar ai.

Të mërkurën, pasi iu dha leja nga policia suedeze për të protestuar, refugjati irakian Salwan Momika shkeli me këmbë një kopje të Kuranit dhe ndezi disa faqe jashtë xhamisë më të madhe të Stokholmit.

Incidenti i cili përkoi me fillimin e festës myslimane të Kurban Bajramit dhe përfundimin e pelegrinazhit vjetor në Mekë të Arabisë Saudite, shkaktoi protesta

në Irak dhe gjetkë.

Kristersson bëri thirrje për qetësi dhe reflektim.

Policia suedeze i kishte dhënë Momikës, 37 vjeç, leje për ta organizuar protestën e tij në përputhje me mbrojtjen e fjalës së lirë. Ajo më vonë tha se kishin nisur një hetim për “agjitacion kundër një grupi etnik”, duke vënë në dukje se Momika kishte djegur faqe nga libri i shenjtë i myslimanëve. “Unë mendoj se vetëm për shkak se disa gjëra janë të ligjshme, ato nuk janë domosdoshmërisht të përshtatshme”, tha Kristersson.

Në Irak protestuesit të enjten u futën për pak kohë në rrethojat e Ambasadës Suedeze në Bagdad. “Është sigurisht krejtësisht e papranueshme të kesh njerëz që hyjnë në mënyrë të paligjshme në ambasadat suedeze në vende të tjera”, tha Kristersson.

Autorizimi për demonstratën e Momikës erdhi dy javë pasi një gjykatë suedeze e apelit refuzoi një vendim të policisë për të mohuar lejet për dy protesta në Stokholm,



të cilat do ta përfshinin djegien e Kuranit.

Policia në atë kohë kishte përmendur shqetësimet e sigurisë, pas djegies së Kuranit jashtë Ambasadës së Turqisë në janar, e

cila çoi në protesta, thirrje për bojkot të mallrave suedeze dhe bllokoi më tej procesin e Suedisë për anëtarësim në NATO, proces ky që po bllokohet nga Turqia. Pas djegies së Kuranit në janar,

Turqia ndërpreu përkohësisht bisedimet e pranimit të Suedisë në NATO.

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka dënuar djegien e fundit të Kuranit.



Dodik padit veten

SARAJEVË, 30 QERSHOR - Millorad Dodik, presidenti i entitetit të Republikës Sërpska, njoftoi se ka ngritur padi penale ndaj vetes, kryetarit të Parlamentit boshnjak dhe dhjetëra ligjvënësve lidhur me legjislacionin që rregullon kompetencat e zyrtarëve.

Lëvizja e Dodikut është pjesë e rezistencës së kamotshme ndaj autoriteteve qendrore të Bosnjës dhe është pjesë e një mospajtimi lidhur me votimin në Asambleenë e Republikës Sërpska për të mos njohur më vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës.

Më 27 qershor Asambleja e Republikës Sërpska votoi një sërë hapash të orkestruara nga Dodiku dhe aleatët e tij serbë, që synojnë t'i refuzojnë strukturat e ndarjes së pushtetit që ekzistojnë në Bosnjë. Këto ndarje të pushtetit janë përcaktuar në



Marrëveshjen e Dejtonit që i dha fund luftës në Bosnjë. Marrëveshja e arritur më 1995

ka ndarë funksionet qeveritare, administrative dhe funksionet e tjera përmes

vijave etnike mes shumicës boshnjake, serbe dhe kroate. Legjislacioni që ka marrë

mbështetjen e Dhomës së Ulët të Parlamentit të Republikës Sërpska duhet ta marrë edhe mbështetjen e Dhomës së Lartë dhe miratimin e nivelit presidencial në këtë entitet.

Nëse merr këtë mbështetje, legjislacioni mund të hyjë në fuqi në gusht. Nëse ndodh kjo, atëherë do të ishte një goditje për kontrollin e pushteteve në Bosnjë.

Përfaqësuesi i lartë ndërkombëtar në Bosnjë, Christian Schmidt, po ashtu mund ta anulojë legjislacionin për të ofruar funksionim të institucioneve civile në Bosnjë-Hercegovinë.

Gjykatë Kushtetuese e Bosnjës, po ashtu, mund ta shfuqizojë legjislacionin pasi ai të hyjë në fuqi, por Dodik dhe aleatët e tij me shumë gjasa do ta sfidonin autoritetin e këtij institucioni.

Ushtria ukrainase pretendon për përparime në fushëbetejë

KIEV, 30 QERSHOR - Ushtria ukrainase ka pretenduar se ka arritur disa “suksese” në luftimet në rajonin lindor të Donjeckut përderisa ka shqetësime lidhur me mundësinë e betejave që kërcënojnë të shkaktojnë një katastrofë në centralin bërthamor të Zaporizhjes në jug të shtetit.

Raportohet për luftime të

ashpra teksa pushtimi rus i Ukrainës po hyn në muajin e 16. Liderët e Bashkimit Evropian gjatë një samiti dyditor në Bruksel u zotuan për vazhdimin e mbështetjes ushtarake për Ukrainën “për aq kohë sa të jetë e nevojshme”.

Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase tha më 30

qershor se “përpjekjet kryesore” të Rusisë po përqendrohen përreth Limanit, Bahmutit dhe Marijinkës, ku “luftimet e ashpra po vazhdojnë”. Kievi tha se “betëja të ashpra” po vazhdojnë, por trupat e tij po vazhdojnë t’u bëjnë presion forcave ruse në qytetin e Bahmutit.



Diplomoi gjenerata e 15 e kadetëve të FSK-së, Kosova po forcon ushtrinë

Nga e premtja 15 oficerë të rinj u shtuan në radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) për t'i shërbyer me vullnet dhe përkushtim atdheut. Ata janë formësuar si udhëheqës me karakter të fortë, të gatshëm për ta ruajtur stabilitetin dhe paqen në vend, sigurinë përtej kufijve tanë shtetëror si pjesë e stërvitjeve dhe operacioneve ndërkombëtare kudo dhe kurdo që të jetë e nevojshme

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Të premtën ka diplomuar gjenerata e 15 e kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ceremonia e diplomimit të tyre është zhvilluar në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë.

Kryeministri Albin Kurti ishte pjesëmarrës dhe folës kyç në ceremoninë e diplomimit të gjeneratës së 15-të të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në ceremoninë ku 15 kadetë pranuan titullin e oficerëve të

Republikës dhe të FSK-së, kryeministri Kurti e cilësoi zhvillimin e Forcës dhe edukimin ushtarak si një hallkë tejet e rëndësishme e cila u ndërtua mbi themelet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe që në të ardhmen e afërt do të jetë pjesë e NATO-s. "Diplomimi i sotëm nga Qendra për Studime Universitare e Akademisë së Mbrojtjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës na jep shpresë për të ardhmen e na bën krenarë për të kaluarën. Na kthen prapa në kohë, në vitin 2009, te gjenerata e parë e diplomuar e Forcës së Sigurisë së Kosovës në këtë qendër, e në vitin 1999, te gjenerata e parë e diplomuar e epërëve të Ushtrisë Çlirimtare të



Kosovës nga shkolla ushtarake "Hamëz Jashari", ka theksuar kryeministri Kurti.

Ai tregoi se përgjatë dy vjetëve të para të qeverisjes, 3 325 ushtarakë janë trajnuar jashtë

vendit, mbi 8 herë më shumë sesa në vitet 2019 e 2020, ndërkohë ka thënë se janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Mbretërinë e Bashkuar, Shqipërinë, Letoninë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kroacinë, ndërkaq janë në proces marrëveshjet SOFA me Gjermaninë, Turqinë, Jordaninë dhe Kroacinë. "E gjitha kjo ka mundësuar që Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë së Kosovës ta ndërtojë imazhin e një institucioni të edukimit ushtarak që nxjerrë oficerë që shkëlqejnë në edukimin pasues ushtarak, në shkollat e kolegjeve të njohura të shteteve partnere e mike", ka thënë Kurti.

Për një Kosovë më të sigurt, më të drejtë e më të barabartë për të gjithë, kryeministri tregoi se Forcën e Sigurisë së Kosovës e kanë bërë të hapur për çdo të re e të ri të deri në moshën 25-vjeçare, duke larguar kufizimin në numër të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

"Rrjedhimisht për dy vjet janë rekrutuar 1 240 ushtarë të rinj, derisa në proces të rekrutimit janë edhe 612 ushtarë aktivë dhe 388 rezervë, me ç'rast radhët e forcës sonë janë rritur për 83 %", ka theksuar ai.

Gjatë fjalës, kryeministri u shpreh se pikërisht Forca e Sigurisë së Kosovës është realiteti ynë dhe jetësimi i idealeve të luftëtarëve dhe të rënëve për liri, andaj edhe kemi dyfishuar buxhetin për ushtrinë në 141.2 milionë euro dhe investimet në armatime i kemi rritur për 191 %. "Ne nuk e forcojmë ushtrinë për të sulmuar të tjerët, por për të qenë mjaftueshëm të fortë për ta mbrojtur vetveten. Për një Kosovë më të sigurt, më të drejtë e më të barabartë për të gjithë", ka thënë kryeministri Kurti.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, komandanti i FSK-së, Bashkim Jashari, gjeneralë të FSK-së dhe familjarë të kadetëve të diplomuar.



Lista Serbe pas vendimit për shpalljen e organizatave terroriste: KFOR-i dhe EULEX-i ta pengojnë planin e Kurtit

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Vendimin e Qeverisë së Kosovës për të shpallur organizata terroriste "Mbrojtjen Civile" dhe "Brigadën e Veriut", Lista Serbe e ka vlerësuar si "pjesë të planit të regjimit të kryeministrit [të Kosovës] Albin Kurti për ta vazhduar terrorin politik në veri të Kosovës dhe arrestimin e serbëve. "Planet që dalin nga ky vendim tregojnë se në vend të shtensionimit në bazë të thirrjeve të gjithë bashkësisë ndërkombëtare dhe mbarë popullit serb, Kurti po planifikon përshkallëzim të mëtejshëm, represion dhe konsolidim të pushtetit parapolitor dhe

pushtues në veri të Kosovës", u tha në njoftimin e Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë.

Më 29 qershor Qeveria e Kosovës i shpalli "Mbrojtjen Civile" dhe "Brigadën e Veriut" organizata terroriste, duke argumentuar se këto organizata qëndrojnë pas trazirave në veri të Kosovës dhe se ato paraqesin "kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë për rendin kushtetues dhe sigurinë në Kosovë".

Lista Serbe edhe një herë u bëri thirrje misionëve të NATO-s dhe Bashkimit Evropian në Kosovë, KFOR-it dhe EULEX-it, t'i vendosin menjëherë forcat e tyre



në veri të Kosovës në mënyrë që ta "parandalojnë Kurtin që ta realizojë planin e tij djallëzor dhe ta rrezikojë paqen".

Autoritetet në Kosovë kanë sqaruar se vendimi për shpalljen e këtyre dy organizatave terroriste nuk do të prekë askënd

që mund të ketë kryer vepra penale para këtij vendimi.

Sipas ligjit në Kosovë, kur organizatat shpallen terroriste, aktiviteti i tyre ndaloheq menjëherë. Çdo aktivitet i mëtejshëm i tyre do të bartë pasojat e rënda ligjore.

"Mbrojtja Civile" dhe "Brigada e Veriut" - organizata që veprojnë në veri të vendit, të banuar me shumicë serbe - numërojnë qindra pjesëtarë të tyre nga radhët e komunitetit serb.

Ndërkaq, Shtetet e Bashkuara kanë thënë se Kosova nuk është koordinuar me të për këtë vendim, as me partnerët e tjerë ndërkombëtarë.



Liderët e BE-së kërkojnë shtensionim në Kosovë, paralajmërojnë pasoja

Udhëheqësit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian kanë bërë thirrje të premtën për shtensionim të menjëhershëm të situatës në veri të Kosovës, ndërsa kanë paralajmëruar pasoja në rast të dështimit. Në tekstin e Këshillit Evropian theksohet se zgjidhja e problemeve duhet bërë në bazë të rekomandimeve të 3 qershorit të BE-së që përfshijnë pezullimin e operacioneve policore, që kryetarët e komunave t'i kryejnë përkohësisht detyrat e tyre në objekte të tjera, shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme dhe pjesëmarrjen e serbëve në këto zgjedhje

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Udhëheqësit e shteteve dhe qeverive të Bashkimit Evropian në samitin që u mbajt në Bruksel të premtën, kërkuar shtensionim të menjëhershëm të situatës në Kosovë dhe paralajmëruan "pasoja negative" nëse nuk bëhet një gjë e tillë.

Në konkluzionet e miratuara në fund të samitit dyditor në Bruksel, liderët përsëritën "përkushtimin e tyre të plotë dhe të qartë ndaj perspektivës së vendeve të Ballkanit Perëndimor për anëtarësimin në BE".

Më tej, u ritheksua "mbështetja për përshtetimin e procesit të pranimit të bazuar në merita dhe reforma përkatëse".

Një paragraf i veçantë i konkluzioneve u kushtohet tensioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe në samit

raporti iu dorëzua liderëve të BE-së nga shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell. "Këshilli Evropian dënon incidentet e fundit të dhunshme në veri të Kosovës dhe bën thirrje për një shtensionim të menjëhershëm të situatës, bazuar në elementet kyçe që Bashkimi Evropian i ka theksuar tashmë më 3 qershor 2023. Palët duhet të krijojnë kushte për zgjedhjet e parakohshme në të katër komunat e veriut të Kosovës. Dështimi i shtensionimit të tensioneve do të ketë pasoja negative", theksuan liderët në konkluzionet e miratuara.

Ata theksuan se është thelbësor vazhdimi i dialogut me ndërmjetësimin e BE-së dhe zbatimi i shpejtë i Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit dhe Aneksit të saj.

Në konkluzione, shtohet se këtu përfshihet edhe formimi i Asociacionit të Komunave me

Shumicë Serbe në Kosovë.

Edhe pse konkluzionet u përgatitën me kohë dhe nuk u kontestua përmbajtja e tyre, miratimi ishte i pasigurt deri në momentin e fundit, sepse ishte një paketë konkluzionesh me të gjitha temat që ishin në rend dite gjatë dy ditëve sa u zhvillua samiti.

Në ditën e parë liderët trajtuan situatën në veri të Kosovës dhe tensionet e shkaktuara në dy raste: në fillim të samitit, kur në takim mori pjesë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, dhe më vonë gjatë ditës, në takimin e krerëve të shteteve dhe qeverive të BE-së. Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Borell, shkroi në "Twitter": "Dje rikonfirmuam mbështetjen tonë të palëkundur për Ukrainën dhe gatishmërinë tonë për ta garantuar angazhimin e ardhshëm të sigurisë. Sot një diskutim i rëndësishëm për Kinën dhe

sigurinë ekonomike. Unë do t'u raportoj liderëve për zhvillimet e fundit në veri të Kosovës".

**Gërvalla për masat
ndëshkuese të BE-së:
Dërgojnë mesazh të
rrezikshëm**

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, i cilësoi "të panevojshme" masat e ndërmarra nga Bashkimi Evropian kundër Kosovës, duke theksuar se ato përcjellin "mesazh të rrezikshëm".

Blloku evropian ka paralajmëruar se këtë javë do të shpallë një varg masash ndaj Prishtinës për shkak se kjo e fundit, siç ka thënë Brukseli, nuk ka marrë hapa për shtensionimin e situatës në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. "Ne mendojmë që masat e tilla janë të panevojshme për shkak se është shumë e rëndësishme që në një situatë të tillë në të cilën ndodhemi, mesazhi t'i dërgohet qartë dhe pa asnjë mundësi për keqkuptim atyre të cilët i kanë krijuar trazirat në pjesën veriore të Kosovës, në katër komunat tona", tha Gërvalla.

Kryediplomatja e Kosovës tha se këto vendime të Brukselit po dërgojnë "mesazhe të

rrezikshme" në Beograd. "Personalisht mendoj se mesazhe të tilla janë të rrezikshme sepse mund ta krijojnë përshtypjen te presidenti serb [Aleksandar] Vuçiq që mund të vazhdojë me të njëjtën mënyrë, të destabilizojë jo vetëm Kosovën, por edhe gjithë fqinjët e tjerë që ka rreth e rrotull", ka deklaruar të premtën Gërvalla.

Në mesin e masave ndëshkuese pritet të jetë pezullimi i punës i të gjitha grupeve punuese për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA). Po ashtu, është paralajmëruar se do të pezullohet financimi i programeve të BE-së, mosmiratimi i projekteve nga Fondi për Investim në Ballkanin Perëndimor si dhe pezullimi i takimeve në nivele politike.

Zyrtarët evropianë kanë thënë se këto masa "nuk janë marrë me lehtësi" dhe ato mund të hiqen në rast se Kosova ndërmerr hapa drejt shtensionimit të situatës.

Tensionet në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, janë rritur që nga fundi i majit. Serbët lokalë po kundërshtojnë kryetarët e rinj shqiptarë, që u zgjodhën më 23 prill, në votimet që u bojkotuan nga popullata serbe.

BE-ja i ka parashtruar disa kërkesa Qeverisë së Kosovës

Hovenier: Qeveria e Kosovës po na habit me refuzimin e kërkesave të miqve të saj

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, tha se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë shumë të shqetësuara me faktin se Qeveria e Kosovës nuk është duke ndërmarrë hapa konkretë për shtensionimin e situatës në veri të shtetit. Duke folur në emisionin Rubikon të Klan Kosovës, Hovenier tha se kryeministri Albin Kurti duhet ta nisë zbatimin e planit trepikësh të propozuar nga Bashkimi Evropian për dalje nga situata e tensionuar në veri. Ky plan, sipas ambasadorit Hovenier, është ajo çfarë, përveç ShBA-ja, kërkojnë BE-ja dhe Mbretëria e Bashkuar. "Miqte e Kosovës, vendet dhe institucionet që më së shumti

kanë luajtur rol në mbështetjen e Kosovës në këtë trajektore, të gjitha po kërkojnë nga Kosova, nga kjo qeveri, që të ndërmarrë disa veprime specifike dhe që ta zbatojë planin trepikësh të BE-së", tha Hovenier. Plani trepikësh i kërkon Kosovës shtensionimin e situatës në veri, mbajtjen e zgjedhjeve të reja dhe kthimin në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Hovenier tha se është e habitshme se pse nuk ka një përgjigje pozitive nga Qeveria e Kosovës. "Jemi të habitur. Është e vështirë për ne ta kuptojmë se përse kjo kërkesë nuk merr përgjigje pozitive dhe nuk duket që do të ketë", tha ambasadori

Hovenier. Hovenier nuk përjashtoi pasojat të tjera për Kosovën në rast se Qeveria e Kosovës nuk u përgjigjet kërkesave të partnerëve ndërkombëtarë. "Është e qartë se do të ketë disa pasojat të tjera nëse vazhdojmë në këtë rrugë ku Qeveria e Kosovës nuk u përgjigjet kërkesave të të gjithë miqve të saj, nga të gjitha shtetet, që kanë treguar një apo dy dekada përkushtim që ta shohin Kosovën duke zënë vendin e saj në Evropë dhe në strukturat euroatlantike", tha Hovenier. Ai mohoi zërat kritikë se ShBA-ja është duke u treguar më e ashpër me Kosovën se me Serbinë, duke thënë se edhe nga Serbia është duke u kërkuar zbatimi i planit

trepikësh. Duke komentuar dërgimin e njësive speciale të Policisë së Kosovës në komunat veriore, Hovenier tha se ajo nuk është mënyra më e mirë për ta mbajtur situatën në kontroll si dhe përmendi, siç tha ai, shqetësimet e shfaqura nga qytetarë të pjesës veriore për praninë e madhe të zyrtarëve policorë të njësive speciale të Kosovës. Përkundër mospajtimeve, Hovenier tha se ShBA-ja e konsideron kryeministrin Kurti partner por, siç tha ai, Kurti duhet të punojë për shtensionimin e situatës dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Hovenier tha se kryetarët

aktualë duhet ta ushtrojnë detyrën në vende të tjera alternative deri në shpalljen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore. Kjo, sipas tij, do t'i kontribuonte shtensionimit të situatës atje. Hovenier tha se në zgjedhjet e ardhshme lokale në komunat veriore, të banuara me shumicë serbe, ShBA-ja pret dalje në zgjedhje të qytetarëve të këtyre katër komunaleve dhe se për këtë janë në diskutime me serbët lokalë në Kosovë si dhe me Beogradin zyrtar. Ambasadori Hovenier tha se duhet të shihet me shqetësim letra e tetë senatorëve amerikanë që iu drejtua presidentit amerikan Joe Biden për ta shprehur shqetësimin e tyre për situatën e tensionuar në veri të Kosovës.



për shtensionimin e situatës. Një prej tyre është shpallja e zgjedhjeve të parakohshme në veri të vendit; Kurti që t'i tërheqë njësitë speciale të Policisë së Kosovës nga zonat rreth objekteve komunale, ku gjenden aktualisht; kryetarët e zgjedhur shqiptarë të punojnë

përkohësisht në ndërtesa alternative e jo në ato komunale dhe rikthimi në dialogun për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se pavarësisht se Komisioni Evropian më 28 qershor ka prezantuar para

Parlamentit Evropian një listë të masave kundër Kosovës, Prishtina vazhdon të jetë partnerja "më e sigurtë dhe më e qëndrueshme në rajon" e bllokut sa iu përket vlerave evropiane. Gjatë mbledhjes së Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 29

qershor, Kurti tha se Kosova në disa raste ka qenë kritike ndaj BE-së, por "asnjëherë cinike dhe as e hidhëruar", duke shtuar se autoritetet nuk janë të hidhëruara as pas prezantimit të masave ndëshkuese. "Pavarësisht prej zhvillimeve rrethanore, ne e

vlerësojmë përkrahjen e ndihmën e Bashkimit Evropian përgjatë gjithë këtyre viteve, dhe mezi e presim pyetësorin për anëtarësim sepse Evropa është kontinenti ynë. Bashkimi Evropian është fati ynë", ka theksuar Kurti.

Në Spitalin e Prizrenit për herë të parë fillon shpërndarja e terapisë tabletare onkologjike

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRIZREN, 30 QERSHOR - Pacientët e rajonit të Prizrenit më nuk do të kenë nevojë të udhëtojnë në Klinikën e Onkologjisë për ta marrë terapinë tabletare onkologjike, ngaqë nga dita e sotme këtë terapi do të mund ta marrin në Spitalin e Prizrenit. Me këtë rast, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se është shumë i lumtur që falë një pune intensive nga Ministria e Shëndetësisë, ShSKUK-ja, Klinika e Onkologjisë dhe Spitali i Prizrenit, sot po arrijnë që këtë terapi ta japin në Spitalin e Prizrenit, pa pasur nevojë që pacientët të udhëtojnë në Prishtinë. “Falë punës intensive kemi arritur që këtë ta jetësojmë disa muaj më herët sesa që ishte planifikuar. Kjo do të jetë lehtësim për qytetarët e rajonit të Prizrenit dhe do ta lehtësojë punën edhe

të stafit të Klinikës së Onkologjisë që është i mbingarkuar”, u shpreh ministri Vitia. Sipas tij, krahas kësaj po investohet në infrastrukturë në Klinikën e Onkologjisë, ku po shtohen kapacitetet ekzistuese me shtretër dhe shërbime shëndetësore.

Zëvendësuesja e drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Narqize Arënlju-Hoxhaj, tha se në projekt është paraparë shpërndarja e terapisë tabletare në Spitalin e Prizrenit dhe atë të Pejës, me qëllim që pacientët ta kenë më lehtë të marrin terapinë e mos të detyrohen të udhëtojnë në Prishtinë.

Drejtori i Klinikës së Onkologjisë, Ilir Kurtishi, tha se mbi 100 pacientë nga rajoni i Prizrenit do të marrin terapinë tabletare një herë në muaj në Spitalin e Prizrenit, ku një mjek specialist onkolog dhe një infermiere nga Klinika e



Onkologjisë do të vijnë në spital si asistencë. Ai përmendi investimet që po bëhen nga

MSh-ja dhe ShSKUK-ja, e që do ta lehtësojnë marrjen e shërbimeve shëndetësore për

pacientët, duke shtuar se furnizimi me terapi onkologjike është i kënaqshëm.

Kuvendi Komunal i Gjilanit e shkarkon kryesuesin Arianit Sadiku



GJILAN, 30 QERSHOR - Kuvendi Komunal i Gjilanit, në një seancë të jashtëzakonshme, të cilën e ka udhëhequr anëtari më i vjetër, Ismajl Kurtishi, me 19 vota për dhe një kundër e ka shkarkuar kryesuesin e deritashëm Arianit Sadiku. Kërkesën për shkarkimin e kryesuesit, në emër të 19 anëtarëve të Kuvendit, të cilët e kanë iniciuar këtë çështje, e ka arsyetuar Avdyll Aliu (LDK). Aliu ka thënë se Kuvendi nuk ka funksionuar mirë që prej fillimit, ndërkaq prej korrikut të

vitit 2022 e këndej është futur në krizë dhe nuk po mund të funksionojë si pasojë e mungesës së bashkëpunimit, prandaj nuk ka kuptim për të vazhduar kësaj më tutje. Kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka thënë se adresimi për dështimin e seancave të Kuvendit Komunal nuk mund të drejtohet vetëm nga një person, sepse kryesuesi e ka për obligim vetëm administrimin e seancës, por jo edhe sigurimin e numrave. Për më tepër, ai tha se qëllimi i

opozitës përmes kësaj loje të fshehtë e tinëzare është diku tjetër. “Kjo është një tentativë për ta prishur LV-në ndërmjet vete, siç u veprua me koalicionin, por kjo nuk do të ndodhë”, tha Hyseni. Kryesuesi i ri i Kuvendit nuk ka mundur të zgjidhet të premten, meqë ishte vetëm një propozim, Kushtrim Kadriu (Vatra), ndërkaq, sipas statutit, duhet të jenë së paku dy propozime. Seanca i ndërpreu punimet për ta vazhduar javën e ardhshme.

Shpalosen të arriturat e strategjisë së policimit në bashkësi

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me OSCE-në, përmes punëtorisë së radhës, ka shpalosur të arriturat e aktiviteteve dhe objektivave përmes raportimit periodik të planit të veprimit sipas Strategjisë së policimit të drejtuar nga Inteligjenca e Policimit në bashkësi.

Pjesëmarrëse në këtë punëtori ishte drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, së bashku me menaxhmentin e lartë të PK-së, drejtorët e drejtorive rajonale, përfaqësuesit nga OSCE-ja, ICTAP-i dhe IPK-ja.

Drejtori Hoxha e cilësoi këtë strategji si një ndër strategjitë më

të rëndësishme të PK-së përmes së cilës synohet rritja e partneritetit dhe bashkëpunimit me komunitetin, shërbimi sa më efektiv dhe efikas ndaj qytetarëve për një siguri edhe më të madhe në vend.

Po ashtu, drejtori i përgjithshëm i PK-së i ka falënderuar partnerët vendorë si dhe ata ndërkombëtarë për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme, në veçanti i ka falënderuar zyrtarët policorë për punën dhe angazhimin e tyre të pakursyer.

Gjatë kësaj punëtorie u raportua për të arriturat nga ky plan i veprimit i cili në përbërje ka pesë objektiva, 27 nënobjektiva si dhe 99 aktivitete, me ç'rast është



raportuar nga të gjitha drejtoritë rajonale, departamentet si dhe drejtoritë në nivel qendror. Policia e Kosovës me qëllim të ngritjes së nivelit të

profesionalizmit dhe arritjes së rezultateve sa më pozitive do ta vazhdojë aplikimin e metodave të cilat praktikisht pritet të rezultojnë sa më efektive si dhe, njëherësh, i

falënderon të gjithë përkrahësit e saj të cilët e mbështetnin PK-në në formën e ndryshme, me qëllim të përmbushjes së objektivave të saj si institucion.

Moskompensimi i dëmeve nga vërshimet falimenton biznese



PRISHTINË, 30 QERSHOR – Liridon Geci nga fshati Llaushë i Skenderajt u detyrua ta mbyllë fermën e pulave për shkak të dëmtimeve që i shkaktuan vërshimet në muajin janar. Edhe pse kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj nga ajo kohë, ai nuk ka marrë asnjë kompensim për dëmet, edhe pse autoritetet qendrore kanë premtuar se do t'i shpagojnë ato.

Radio Evropa e Lirë iu drejtua Qeverisë së Kosovës me pyetje për këtë çështje, por nuk mori përgjigje.

Geci tregon se, si pasojë e vërshimeve, i kanë ngordhur 12 000 pula, nga 15 000 sa kishte gjithsej. Për shkak të dëmeve që i ka pësuar edhe inventari, ai thotë se është detyruar t'i shesë edhe pulat e mbetura dhe ta mbyllë fermën me pesë punëtorë.

Nga kjo pulari thotë se ka siguruar jetesën e familjes, ndërsa vlera e dëmeve që ka pësuar thotë se është rreth 400 mijë euro. "Biznesi ka falimentuar. Nuk kemi mundur të bëjmë riparime sepse

vlera financiare është e papërbalueshme për biznesin tonë. Po presim kompensim të mjeteve. Kemi telashe edhe me banka, kemi kredi dhe nuk kemi pasur mundësi t'i paguajmë këstet e kredive", thotë Geci për Radion Evropa e Lirë.

Vërshimet e 19 janarit në Skenderaj kanë dëmtuar ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore dhe infrastrukturë rrugore. Sipas kryetarit të komunës, Fadil Nura, dëmet kanë arritur vlerën e mbi 12.2 milionë eurove. Ai thotë se lista e dëmeve është dërguar tek autoritetet përgjegjëse, porse deri më tash nuk ka pasur përgjigje prej tyre. "Komuna e Skenderajt brenda afateve të parapara ligjore ka dërguar dosjen për secilën familje të prekur - ekonomi familjare, rast bujqësor, biznes dhe infrastrukturë publike... Nga niveli qendror, deri më tani, nuk ka ndonjë lëvizje sa i përket kompensimit. A është çështje vullneti apo politike, nuk e di", thotë Nura për Radion Evropa e

Lirë.

I vetmi kompensim që është bërë në këtë komunë, sipas tij, është ai nga Fondi Emergjent i Vërshimeve, i cili është themeluar menjëherë pas vërshimeve nga vetë komuna e Skenderajt. "Gjatë kohës sa fondi ka qenë i hapur janë grumbulluar nga njerëz të vullnetit të mirë, bashkatdhetarë, shoqata, fundacione dhe të tjerë, mbi 414 mijë euro. Ato janë ndarë në mënyrë proporcionale për 373 familje - nga mbi 1 100 euro", thotë Nura.

Përveç komunës së Skenderajt, vërshimet në janar kanë përmbytur edhe zona në Mitrovicë të Jugut, Klinë dhe Istog. Sipas llogaritjeve që kanë bërë komunat përkatëse, mbi 7.8 milionë euro ka qenë vlera e dëmeve në Mitrovicë të Jugut, mbi 4 milionë euro në Klinë dhe rreth 2.8 milionë euro në Istog. Derisa të prekurit në këto komuna janë në pritje të kompensimit, përmbytjet përfshin fundjavën që shkoi edhe rajonin e Pejës. Dy persona

humbën jetën nga përmbytjet, që shkaktuan edhe dëme të mëdha materiale.

Kryetari i Pejës, Gazmen Muhaxheri, konfirmon se evidentimi i dëmeve ka nisur më 26 qershor.

Asociacioni i Komunave o Kosovës kërkon nga qeveria e vendit t'i kompensojë fillimisht dëmet e shkaktuara nga vërshimet e muajit janar. Sazan Ibrahim, kryetar i këtij asociacioni, thotë se është i domosdoshëm krijimi i një fondi emergjent për t'iu shmangur vonesave në kompensim. "Politikat, sa i përket kompensimit të dëmeve, duhet të rishqyrtohen, në mënyrë që të krijohet fondi emergjent për komuna. Këto mjete pastaj të barten në nivelin lokal, në mënyrë që ky nivel sa më shpejt ta bëjë kompensimin e dëmeve. E jo të kalojnë muaj të tërë - pesë, gjashtë apo më shumë muaj - e qytetari të mos kompensohet nga niveli qendror", thotë Ibrahim për Radion Evropa e Lirë.

Në rast se nuk ka ndonjë fatkeqësi natyrore, Ibrahim thotë se këto mjete do të mund t'i ktheheshin nivelit qendror.

Në mbledhjen e qeverisë të enjten, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se vendi do të fillojë ta hartojë "strategjinë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike".

Ai tha se Kosova është duke lobuar për të siguruar që të ketë qasje të drejtpërdrejtë në fondet për këtë qëllim.

Vlerësohet se asaj i duhen investime prej më shumë se 1.3 miliard eurosh në infrastrukturë. "Ndërtimet në zonat me rrezik nga përmbytjet dhe mungesa e sistemeve të drenazhit në disa zona urbane kontribuojnë për të keq në rritjen e pasojave nga përmbytjet e shpeshta", tha Kurti. Shirat e rërmyshëm shkaktajnë shpesh përmbytje në Kosovë.

Dëmtimi i shtretërve të lumenjve, si pasojë e nxjerrjeve të paligjshme të zhavorrit, thuhet se kontribuon, po ashtu, në përmbytjen e zonave.

Qeveria miraton Agjendën Digjitale të Kosovës 2030

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e fundit ka miratuar Agjendën Digjitale të Kosovës 2030, e cila është hartuar dhe propozuar nga Ministria e Ekonomisë.

Agjenda Digjitale e Kosovës 2030 është strategji qeveritare ndërsektoriale që përcakton politikën dhe prioritetet e veçanta të Kosovës në kontekstin e transformimit të vazhdueshëm digjital të ekonomisë dhe shoqërisë, e ndikuar nga teknologjitë inovative dhe trendët digjitalë botërorë.

Agjenda Digjitale merr në konsideratë objektivat strategjike të strategjisë kombëtare të



zhvillimit, strategjisë kombëtare të TI-së dhe dokumenteve të tjera të politikave socio-ekonomike të

Kosovës, si dhe është në përputhje të plotë me strategjitë dhe rekomandimet më të fundit

të Bashkimit Evropian, p.sh., Kompassi Digjital 2030, Marrëveshja e Gjellbër, Formësimi

i së Ardhmes Digjitale të Evropës, Rruga e Programit të Politikave 2030 për dekadën digjitale, Strategjia e Shoqërisë Gigabit, Plani i Veprimtimit 5G, Siguria Kibernetike e Rrjeteve 5G etj.

Para miratimit në qeveri, Agjenda Digjitale ka qenë në konsultime publike si dhe janë mbajtur takime me përfaqësues të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, ku janë paraqitur idetë dhe komentet e tyre në mënyrë që dokumenti i Agjendës Digjitale të Kosovës 2030 të jetë sa më efektiv dhe i përdorshëm, sidomos nga sektori i TIK-ut dhe institucionet publike dhe private.

Nga Guri Filozofik tek shkenca moderne: A është e vërtetë alkimia?



Nga Theo HARRISON

A është e vërtetë alkimia? A mund ta kthehet vërtetë në ar çdo lloj metali bazë? Akimia ka tërhequr ndër shekuj vëmendjen e kimistëve. Madje na ka nxitur të pyesim veten se a mund të bëhemi miliarderë brenda natës duke kthyer në ar metalet e zakonshme? Por a është e mundur kjo gjë?

Alkimia është një praktikë e lashtë filozofike, historike dhe proto-shkencore, e cila synonte të transformonte metalet bazë në metale të çmuara si për shembull në ar. Po ashtu, ajo synonte të gjente një ilaç universal që mund të shëronte të gjitha sëmundjet nga të cilat preket njeriu. Por përveç shndërrimit të metaleve dhe kërkimit të eliksirit të jetës, alkimistët eksploruan gjithashtu natyrën e materies dhe universit, si dhe praktikat shpirtërore dhe mistike.

Për këto arsye, Alkimia luajti një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kimisë dhe mjekësisë moderne, pasi shumë nga teknikat dhe praktikat e përdorura nga alkimistët hodhën themelet për metodat shkencore të përdorura sot. Por alkimia e vërtetë, nuk kishte të bënte vetëm me transformimet fizike, por edhe me ato shpirtërore dhe filozofike. Shumë alkimistë, e panë punën e tyre si një mjet për të arritur

ndriçimin shpirtëror dhe bashkimin me hyjnoren. Ata besonin se transformimet fizike që po kërkonin, ishin të lidhura ngushtë me transformimet e shpirtit. Dhe besonin se duke pastruar dhe transformuar lëndën, ata mund të pastronin dhe transformonin veten.

Pavarësisht nga kontributet e shumta në zhvillimin e shkencës dhe mjekësisë moderne, alkimia nuk konsiderohet sot një praktikë legjitime shkencore ose mjekësore. Gjithsesi ndikimi i saj mund të shihet ende tek gjuha dhe simbolikën e kimisë moderne.

Ndërkaq trashëgimia e saj vazhdon të frymëzojë artistë, shkrimtarë dhe mendimtarë në mbarë botën. Praktika e alkimisë filloi që në Egjiptin helenistik, dhe u përhap në të gjithë botën islame dhe më pas në Evropë gjatë Mesjetës dhe Rilindjes.

Ajo ishte një përzierje e traditave të ndryshme filozofike dhe shkencore, përfshirë filozofinë greke, mitologjinë egjiptiane, misticizmin hebre, shkencën indiane Vedike dhe Ajurvedike dhe shkencën islame. Një nga praktikat kryesore të alkimisë ishte 'Magnum Opus', ose "puna e madhe".

Ky ishte qëllimi përfundimtar i alkimistit, dhe përfshinte një proces të gjatë dhe kompleks pastrimi, transformimi dhe integrimi. "Magnum Opus"

shihej si një transformim fizik dhe shpirtëror, dhe arritja e tij besohej se jepte jo vetëm pasuri dhe fuqi materiale, por edhe ndriçim shpirtëror dhe bashkim me hyjnoren.

Kjo traditë komplekse dhe e shumanshme përfshinte një gamë të gjerë praktikash, besimesh dhe qëllimesh. Alkimistët punuan si në fushën praktike ashtu edhe në atë teorike. Megjithëse shumë nga idetë dhe praktikat e alkimisë nuk konsiderohen sot të vlefshme, disa nga teknikat dhe konceptet e saj kanë ndikuar në kiminë dhe mjekësinë moderne.

Për shembull, alkimistët ishin ndër të parët që zhvilluan teknika për ndarjen dhe pastrimin e përbërjeve kimike, dhe fokusi i tyre tek eksperimentimi dhe vëzhgimi, hodhi themelet për metodën shkencore. Guri Filozofik është një substancë legjendare që kërkohet me ngul nga alkimistët.

Besohej se ai kishte fuqinë për t'i shndërruar metalet bazë në ar ose argjend, dhe për t'i dhënë jetë të përjetshme personit që e zotëronte atë. Ai njihej edhe me emra të tjerë të ndryshëm, si eliksiri i jetës, ilaçi universal dhe kuintesenca. Në simbolikën alkimike, Guri Filozofik përfaqësonte qëllimin përfundimtar të kërkimit alkimik, që ishte transformimi i vetëdijes së vetë alkimistit dhe arritja e

ndriçimit shpirtëror.

Ai përshkruhej shpesh si një substancë e vogël, e fortë, e kuqe ose e bardhë, dhe ndonjëherë si pluhur ose lëng, që mund të krijohet përmes një procesi kompleks distilimi, pastrimi dhe shndërrimit të substancave të ndryshme. Edhe pse ideja e Furit filozofik ishte qendrore në studimin alkimik për shekuj me radhë, askush nuk e zbuloi kurrë atë.

Gjithsesi, ndjekja e gurit filozofik luajti një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kimisë moderne. Alkimia përfshinte një sërë procesesh komplekse dhe të shumanshme si kalcifikimi, pra ngrohjen e një lënde në një temperaturë të lartë në mënyrë që të digte papastërtitë, shpërbërja, ndarja, lidhja, fermentimi, distilimi dhe koagulimi.

Alkimia ka qenë një praktikë e vërtetë historike që ishte e njohur në Evropë dhe Lindjen e Mesme gjatë periudhave Mesjetës dhe epokës së hershme moderne. Por edhe pse mund të jetë praktikuar gjerësisht nga alkimistët gjatë historisë dhe nëpër rajone dhe kultura, ajo nuk konsiderohet një shkencë e vërtetë në kuptimin modern.

Sepse pretendimet e saj për kthimin e metaleve bazë në ar ose krijimin e një kure universale për sëmundjet nuk u realizuan kurrë. Shumë nga praktikat e tij

ishin më shumë të bazuara tek bestytnitë dhe misticizmi sesa tek vëzhgimi dhe eksperimentimet. Po ashtu Alkimia bazohej tek besimet e vjetruara mbi natyrën e materies dhe universit, dhe metodat e saj ishin shpesh joshkencore dhe joefektive. Gjithsesi hodhi bazat e kimisë. Kështu, është një fakt që fosfori u zbulua nga alkimisti gjerman Henig Brand në vitin 1669, gjatë kohës që ai ishte në kërkim të Gurit Filozofik.

Brand kishte eksperimentuar me urinën, për të cilën ai besonte se ishte një përbërës kyç në krijimin e Gurit Filozofik. Në një nga eksperimentet e tij, ai ngrohu sasi të mëdha të urinës derisa ajo nisi të shkëlqejë në errësirë. Kështu u zbulua fosfori, një element shumë reaktiv dhe i dezhshëm. Paradoksalisht zbulimi i fosforit, ndihmoi në diskreditimin e idesë së shndërrimit të një elementi në një tjetër, i cili kishte qenë një fokus qendror i alkimisë. Ndaj në vend të kësaj, shkencëtarët filluan të studiojnë vetitë e elementeve dhe reagimet e tyre me njëri-tjetrin.

Alkimisti më i famshëm ka qenë Paracelsusi (1493-1541), një mjek dhe filozof zviceran që dha një kontribut të rëndësishëm në fushat e kimisë, mjekësisë dhe toksikologjisë.

Marrë me shkurtime nga themindsjournal – bota.al

Gjenerali i hekurt i rrëzuar nga fronti



Për këtë njeri me famë të errët, por me efikasitet shumë të lartë ushtarak në këto orë kishte rifilluar të flitej. Scoop-i u nis nga New York Times: në këto orë inteligjenca amerikane “po përpiqet të kuptojë” nëse Surovikini, një hero i mbrojtjes në terren në orën më të errët të Moskës, e ka ndihmuar disi Evgeny Prigozhinin, si në pushtimin e Rostovit në Don, por edhe në organizimi i Marshimit drejt Moskës. Wall Street Journal gjithashtu i bëri jehonë lajmit. Sipas rindërtimit të burimeve të saj, gazeta pretendon se qëllimi përfundimtar i Prigozhinit dhe bashkëpunëtorëve të tij ishte kapja e Shoigut dhe Gerasimovit, gjatë një vizite që të dy duhej të bënin në jug të Federatës Ruse.

Surovikini, i cili gëzon respektin dhe nderimin e trupave të tij, por edhe admirimin e vetë kreut të Wagnerit, ishte graduar janarin e kaluar. Në ato ditë, në fakt, gradimi i gjeneralit Aleksandër Lapin, nga komandant i Qarkut Ushtarak Qendror në shef të shtabit të forcave tokësore, u lexua si një përgjigje ndaj atyre që kërkonin një angazhim më shkatërrues nga Moska në luftën kundër Ukrainës. Fraksion i cili përfshin gjithashtu themeluesin e Wagner, dhe nënkryetarin e

Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Dmitry Medvedev. Nga ana tjetër, Surovikini u zëvendësua nga Valery Gerasimov, duke u bërë sakrificë e tërheqjes nga Khersoni. Një veprim që u përshëndet, në funksion të ofensivës së pranverës. Fundjavën e kaluar, ndërsa konsumohej epopeja e Prigozhinit dhe njerëzve të tij, Surovikini iu drejtua mercenarëve duke i ftuar ata të hidhnin kapelën. Zyrtarët e cituar nga gazeta amerikane pretendojnë se Surovikini ishte i përfshirë në ngjarjet e javës së kaluar, gjë që do të ishte një shenjë e mëtejshme e luftës vëllavrasëse brenda udhëheqjes ushtarake ruse, midis mbështetësve të Prigozhinit dhe dy këshilltarëve kryesorë të Putinit. Sipas burimeve, afërsia mes Surovikinit dhe Prigozhinit mund të shpjegojë edhe pse ky i fundit është ende gjallë.

“Spekulime!” Kështu zëdhënësi i Kremlinit Dmitry Peskov i cilësoi deklaratat e NYT, duke i ulur ato në nivelin e thashethemeve, lidhur me aferën Prigozhinit. Dyshimet kundër Surovikinit u shtuan gjithashtu nga një raport i publikuar nga platforma Dossier Center e oligarkut Mikhail Khodorkovsky, i cili pretendon se Surovikini ishte në fshehtësi një anëtar nderi i Wagnerit, së bashku me 30

gjeneralë të tjerë të rangut të lartë, që nga viti 2017.

Videoja dhe zhdukja misterioze e Surovikinit

Rikonstruksioni që është bërë pjesërisht, lidhet gjithashtu me “zhdukjen” e supozuar të Surovikinit, duke filluar nga e shtuna e kaluar: prej këtej del edhe hipoteza e arrestimit ose marrjes në pyetje.

Në orët e grushtit të shtetit të supozuar, gjenerali u ishte drejtuar forcave të Wagnerit në një video, me një ton paternalist dhe pajtues në të njëjtën kohë: “Ju bëj thirrje të ndaloni. Armiku vetëm pret që situata e brendshme politike në vendin tonë të përkeqësohet. Ju nuk mund të luani lojën e armikut në këtë kohë të vështirë për vendin” [...] Duhet ta bëni para se të jetë tepër vonë, t’i bindeni vullnetit dhe urdhrave të Presidentit të Federatës Ruse të zgjedhur nga populli. Ndaloni autokolonat – shton ai – kthehuni në bazat tuaja, të zgjidhim gjithçka me mjete paqësore. Së bashku me ju kemi kaluar një rrugë të vështirë – shtoi ai duke iu referuar luftimeve të përbashkëta në Ukrainë –, kemi luftuar së bashku me ju, kemi rrezikuar, kemi pësuar humbje, kemi fituar së bashku. Jemi të një gjaku, jemi luftëtarë”.

Për zyrtarët që folën me


redaksinë e NYT, videoja ishte autentike, por jo e vërtetë: sipas disa analistëve, gjuha verbale dhe joverbale e Surovikinit kishte të gjitha karakteristikat e komunikimit të një “pengu”: me sa duket ishte detyruar t’i drejtohej Prigozhinit si vartës, pavarësisht se kishte ndarë gjithmonë pikëpamjen negative të udhëheqjes ushtarake ruse.

Surovikin dhe Prigozhin, “shokë të vjetër armësh”

Nëse do të kishte prova për këtë mbështetje të jashtme, e cila do të shpjegonte gjithashtu besimin me të cilin Prigozhini ka zgjedhur të marshojë drejt Moskës, edhe Surovikini do të ishte në rrezik. Megjithatë, në komunikimin e Putinit, vulgata e historisë (të paktën deri tani) i referohet gjithmonë dhe vetëm kreut të Wagner-it, pa përfshirë konkluzione kundër sferave të tjera të forcave ruse. Nëse Surovikini do të dëshmonte se është i përfshirë në mënyrë aktive, Putini do të kishte shumë pak opsione në tryezë: megjithatë, kishte shumë që vinin bast se asgjë nuk do t’i ndodhte gjeneralit të hekurt, duke pasur parasysh dhe duke marrë parasysh prirjen e Putinit për zëvendësime dhe për çdo gjë që mund të tradhtonte një dobësi në zinxhirin e komandës.

Por nëse shërbimet sekrete e detyrojnë Kremlinin të veprojnë përballë provave të pakundërshtueshme, kthesa të mëtejshme mund të vijnë nga Moska. Surovikini, për më tepër, është një i dyshuar autoritar, por ai nuk është i vetmi mbi të cilin varen dyshimet e establishmentit rus: i gjithë boshti anti-Shoigu-Gerasimov dyshohet se ka qenë në anën e Prigozhinit. Në fakt, mbetet ende për t’u sqaruar lehtësia groteske me të cilën u mor Rostovi dhe me të cilin krye i gjithë operacioni, të cilin vetëm Wagneri nuk mund ta kryente në mënyrë autonome logjistike pa llogaritur mbështetjen e madhe.

Për më tepër, ka një detaj jo të papërfillshëm: Surovikini dhe Prigozhini janë “shokë të vjetër armësh”: të dy kanë luftuar krah për krah në skenarin sirian dhe shpesh kanë bërë komente të ndërsjella shumë lajkatare. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, të dy mbeten të vetmit, brenda një strategjie dhe taktike ruse absolutisht dështuese, që kanë sjellë rezultate të patëmeta, pavarësisht zgjedhjeve të dyshimta të komandave të larta (Kherson dhe Bakhmut). Kjo sigurisht nuk është provë e mëtejshme i mirëkuptimit mes të dyve. / Il Giornale – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Duka sërish në KE të UEFA-së, merr përsipër përkujdesjen ndaj FFK-së



PRISHTINË, 30 QERSHOR - Federata e Futbollit e Kosovës do të vazhdojë ta ketë përkujdesjen dhe mbështetjen e presidentit të FSHF-së, Armand Duka edhe gjatë mandatit të tij të ri në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-së. Në mbledhjen e fundit të KE të UEFA-së është miratuar shpërndarja e portofolit të anëtarëve të këtij organi dhe FFK-ja do të vazhdojë të jetë nën përkujdesjen e presidentit Duka. Ky i fundit nëpërmjet një shkrese zyrtare e ka informuar presidentin Agim Ademi se është i nderuar për faktin që për të dytin mandat radhazi, FFK-ja do të jetë pjesë e portofolit të tij. “Kjo, jo vetëm që është një

detyrë dhe përgjegjësi e rëndësishme por në të njëjtën kohë edhe shumë domethënëse për mua, për marrëdhënien veçanërisht vëllazërore me FFK-në dhe Kosovën. Ju e dini, që kontributi dhe mbështetja ime në zhvillimin e futbollit në Kosovë ka qenë e përhershme dhe e pakufizuar në çdo moment. Për këtë arsye gjej rastin të uroj që ky 4-vjeçar të ketë vetëm suksese për Ju dhe Federatën tuaj”, ka shkruar Duka në shkresën e tij drejtuar kreut të FFK-së. Duka e ka siguruar presidentin Ademi se do të jetë gjithmonë në dispozicion të tij, jo vetëm si mik i FFK-së dhe personalisht i tij, por edhe si

një katalizator dhe urë lidhëse ndërmjet FFK-së dhe institucionit të UEFA-së. Gjatë mandatit të tij të parë si anëtar i KE të UEFA-së, Duka ka pasur një ndikim të madh në zhvillimin dhe infrastrukturën e futbollit në Shqipëri dhe shtetet e rajonit, duke përfshirë edhe Kosovën. FFK ka realizuar të gjitha projektet e paraqitura në UEFA në këtë periudhë, teksa prania e presidentit Duka në organin më të lartë të UEFA-së dhe marrëdhëniet e shkëlqyeshme me presidentin Ademi janë një mundësi e mirë për të vazhduar zhvillimin e mëtutjeshëm të futbollit në Kosovë në të gjitha segmentet.

Arrestohen trajneri dhe gjyqtari i basketbollit, shkak kurdisjet

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Gjyqtari Daut Mehmeti dhe trajneri Arbnor Rifati u arrestuan të premten në Prizren me dyshimin e përfshirjes në kurdisje të ndeshjeve të basketbollit. Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK), ka realizuar dy operacione policore, në dy raste të veçanta, ku janë arrestuar tre të dyshuar. Sektori i Hetimeve Financiare i DHKEK, më 30 qershor ka zbatuar urdhër kontrollin e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për kontroll në dy lokacione të ndara, njëra në

Prishtinë dhe tjetra në Prizren. Urdhër-kontrolli është zhvilluar me qëllim të sigurimit të dëshmitëve shtesë dhe arrestimin e dy të dyshuarve në lidhje me veprën penale “kurdisje e ndeshje ose sportit”. “I dyshuari i parë (gjyqtari me licencë ndërkombëtare), dyshohet të ketë kurdisur ndeshjet basketbollistike në kuadër të Super ligës së Kosovës, Ligës Unike Kombëtare dhe Ligës Ballkanike, veprimet i ka kryer në bashkëveprim me të dyshuarin e dytë (trajner basketbolli)”, ka njoftuar policia. “Të dyshuarit i kanë

kryer këto veprime me qëllim të përfitimit material. Po ashtu, i dyshuari i parë, ka bashkëvepruar edhe me gjyqtar dhe trajner ndërkombëtar në kurdisjen e lojërave basketbollistike, me qëllim të fitimit të basteve”, thuhet në njoftim. Gjatë kontrollit janë sekuestruar disa fletëpagesa, katër telefona dhe dy shtëpiza të kompjuterit. Të dyshuarve pas intervistimit me urdhër të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, u është shqiptuar masa e ndalimit prej 48 orëve.



Vëllaznimi garon në Ligën e Parë



Gjakovë, 30 qershor - Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova ka njoftuar se nga sezoni i ardhshëm do të garojë në Ligën e Parë. Në njoftimin e klubit gjakovar, thuhet se është arritur marrëveshje që të fuzionohen me KF Drenasin. “Pas shumë angazhimeve, Kryesia e Klubit arriti marrëveshje me KF Drenasin

që të fuzionohen dhe KF Vëllaznimi ti vazhdoj garat në Ligën e Parë, kjo e gjitha falë të gjithë anëtarëve të Kryesisë që u angazhuan dhe u organizuan në mënyrë perfekte deri te zgjidhja e çështjes së Klubit”, thuhet në njoftim. “KF Vëllaznimi deri më tani ishte i regjistruar ligjërisht si K.F.C Vëllaznimi, kurse tash e

tutje emërimi zyrtar dhe ligjor i klubit do të kthehet në emrin historik, gjegjësisht në Klubi i Futbollit “K.F. VËLLAZNIMI” Gjakovë, në këtë mënyrë duke rikonfirmuar vazhdimin e historisë së lavdishme të klubit tonë që nga viti i largët 1927 e deri më sot, dhe duke konfirmuar Logon origjinale dhe ngjyrat kuq e zi të cilat

përfaqësojnë identitetin dhe historinë e klubit tonë”, thuhet në njoftimin e klubit kuqezi. Ata kanë bërë të ditur se së shpejti do njoftojnë për fillimin e stërvitjeve për sezonin 2023/24 dhe rreth lojtarëve që kanë qëndruar në klub dhe atyre të cilët janë bashkuar me klubin gjatë afatit kalimtar veror.

Ademi rikthehet në Superligën e Zvicrës

BASEL, 30 QERSHOR - Futbollisti shqiptar, Kemal Ademi është rikthyer në Superligën e Zvicrës dhe ka firmosur kontratë me skuadrën e FC

Luzernit. 27-vjeçari ishte në Rusi te skuadra e Khimki, por nuk kaloi mjaftë mirë pasi zhvilloi vetëm një paraqitje. Ademi me Luzernin ka

firmosur kontratë deri në vitin 2025. Ai e njeh mjaftë mirë ligën e Zvicrës, pasi më parë ka qenë pjesë e Xamax dhe Baselit. Kujtojmë që

Kemal Ademi kishte refuzuar Kombëtaren e Kosovës para disa viteve dhe momentalisht nuk e përfaqëson asnjë shtet.





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo



**NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA
OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyrueshme.
Prema Zakonu br. 03/L-222 Član 34, dole opisana imovina je konfiskovana od strane Prinudne naplate poreza zbog neplaćanja poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimin administrativ nr.15/2010, neni 37.
Imovina će se prodati putem aukcije zatvorenih ponuda kao što je regulisano "Zakon 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama" član 34 i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

OFERTA DO TË HAPET/PONUDE ĆE SE OTVORITI: 14.07.2023 Për herë të parë/Prvi put.
KOHA/VREME: 10:00
VENDI/MESTO: Zyra e ATK/Kancelarije PAK – Departamenti i mbledhjes së borxheve – Veterinik /Odeljenje naplate dugova-Veterinik

Përshkrimi i pasurisë/Opis imovine:

Pasuria, gjegjësisht 3 lokalet të cilat janë në shitje janë *Imovina, odnosno 3 lokala koji se prodaju, su u vlasništvu*

Pronësia e kesaj pasurie është fituar nga Kontrata për ndërtim të përbashkët me nr. LRP.nr.1370, Ref.nr.300/16 e lidhur me datën 04.05.2016. *IVlasništvo nad ovom imovinom je stečeno Ugovorom o zajedničkoj izgradnji broj: LRP.br.1370, Ref.br.300/16 od 04.05.2016.*

Lokalet gjinden në objektin afaristo – banesor në parcelën me numër P-70403013-03860-1 zonë kadastrale Gjilan./Lokali se nalaze u poslovno-stambenoj zgradi u parceli broj P-70403013-03860-1 katastarske zone Gnjilane.

Lokali nr.1 gjindet në përdhës me sipërfaqe prej 345 m²/ Lokal broj 1 se nalazi u prizemlju sa površinom od 345 m²

Lokali nr.3 gjindet në katin 1 me sipërfaqe prej 107 m²/ Lokal broj 3 se nalazi na 1. spratu površine 107 m²

Lokali nr.5 gjindet në katin 1 me sipërfaqe prej 220 m²/Lokal broj 5 se nalazi na 1. spratu površine 220 m²

Çmimi fillestarë i shitjes/ Početna prodajna cena:

Çmimi fillestar për lokalin nr.1 është 1800-euro për m²/ Početna cena lokala broj 1 je 1800 evra po m²

Çmimi fillestar për lokalin nr.3 është 1300-euro për m²/Početna cena lokala broj 3 je 1300 evra po m²

Çmimi fillestar për lokalin nr.5 është 1200-euro për m²/Početna cena lokala broj 5 je 1200 evra po m²

Kushtet e pjesëmarrjes: Kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancioni bankar) në shumën 10%(minimumi) të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.

Uslovi učešća: uslov učešća na licitaciji, kada prodajemo nepokretnosti, je akontacija (bankarska garancija) u iznosu od 10% neizmirenih poreskih obaveza poreskog obveznika

Paraqitja e Ofertave: Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

Dostavljanje ponuda: Sve ponude moraju jasno da identifikuju ponuđenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu i broj bankovnog računa fizičkog ili pravnog lica koje podnosi ponudu. Ponude moraju biti primljene u zatvorenoj kovrti pre navedenog datuma i gorepomenutog roka.

Kushtet e pagesës, Kërkohet pagese e tërësishme dhe e menjëhershme./ **Uslovi plaćanja,** potrebno je potpuno i blagovremeno plaćanje.

Pasuria mund të inspektohet: Nga data 07.07.2023 deri 14.07.2023 nga ora 09:00 deri 15:00/Imovina se može pogledati: od dana 07.07.2023 do 14.07.2023 od 09:00 do 15:00 časova.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit të mbledhjes/Ime, prezime i službenik naplate:

Data/dana: 29.06.2023



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



**NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA
OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyrueshme.

Prema Zakonu br. 03/L-222 Član 34, dole opisana imovina je konfiskovana od strane Prinudne naplate poreza zbog neplaćanja poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37.

Imovina će se prodati putem aukcije zatvorenih ponuda kao što je regulisano "Zakon 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama" član 34 i Administrativno uputstvo br.15/2010, član 37.

OFERTA DO TË HAPET/ PONUDE ĆE SE OTVORITI: 19.07.2023 Për herë të parë/Prvi put.
KOHA/VREME: 10:00

VENDI/MESTO: Zyra e ATK/Kancelarije PAK – Departamenti i mbledhjes së borxheve – Veterinik /Odeljenje naplate dugova-Veterinik

Përshkrimi i pasurisë/Opis imovine:

Gjindet në fshatin Tërpezë të Malishevës /Celokupna imovina je na ime nalazi se u selu Terpeze u Mališevu.

Parcela/Parcela – P-72310075-01972-0

Parcela /Parcela– P-72310075-01973-1

Parcela/Parcela – P72310075-01973-2

Parcela /Parcela– P72310075-01973-3

Bager/Bager

Gjenerator/Generator

Kompjuteri/Kompjuter

Çmimi fillestar i shitjes/Početna prodajna cena:

Çmimi fillestar për Parcela/Početna cena za parcelu–P-72310075-01972-0, P-72310075-01973-1, P72310075-01973-2, P72310075-01973-3 - 250.000 Euro/evra

Çmimi fillestar për Bager /Početna cena za bager- 15.000 Euro

Çmimi fillestar për Gjenerator/ Početna cena za gjenerator- 10.000 Euro

Çmimi fillestar për Kompjuter/ Početna cena za kompjuter – 200 Euro

Parcelat e përshkruara shiten në tërësi, dmth nuk shiten ndaras, ndërsa pjesët tjera shiten ndaras!! *Opisane parcele se prodaju u celini, odnosno ne prodaju se posebno, dok se ostali delovi prodaju posebno!*

Kushtet e pjesëmarrjes: Kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancioni bankar) në shumën 10%(minimumi) të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.

Uslovi učešća na aukciji; Uslov učešća na aukciji kada prodajemo nepokretnosti, je akontacija (bankarska garancija) u iznosu od 10% neizmirenih poreskih obaveza poreskog obveznika.

Paraqitja e Ofertave: Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

Dostavljanje ponuda: Sve ponude moraju jasno da identifikuju ponuđenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu i broj bankovnog računa fizičkog ili pravnog lica koje podnosi ponudu. Ponude moraju biti primljene u zatvorenoj kovrti pre navedenog datuma i gorepomenutog vremena.

Kushtet e pagesës, Kërkohet pagese e tërësishme dhe e menjëhershme./ **Uslovi plaćanja,** potrebno je potpuno i blagovremeno plaćanje.

Pasuria mund të inspektohet: Nga data 11.07.2023 deri 18.07.2023 nga ora 09:00 deri 15:00

Nekretnina se može pogledati: od dana 11.07.2023 do 18.07.2023 od 09:00 do 15:00 sati

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit të mbledhjes/ Ime, prezime i službenik naplate:

Data/Dana: 30.06.2023





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo

NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyrueshme.

Prema Zakonu br. 03/L-222 Član 34, dole opisana imovina je konfiskovana od strane Prinudne naplate poreza zbog neplaćanja poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37.

Imovina će se prodati putem aukcije zatvorenih ponuda kao što je regulisano "Zakon 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama" član 34 i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

Ofertat do të hapen/ Ponude će biti otvorene: Për herë të parë me datën 11.07.2023 e hënë në ora 10/ Prvi put 11.07.2023 ponedeljak u 10 časova

Vendi i shitjes/ Prodajno mesto: Zyra e Atk - Departamenti i mbledhjes së borxheve - Veternik (prapa Albi mall); PAK kancelarije - Odeljenje za naplatu dugova - Veternik (iza Albi tržnog centra)

Përshkrimi i pasurisë/Opis imovine:

1.Parcellë tokë Bujqësore (Arë e kalasës 4) Njesia kadastrale me numer parcelle P-72809072-01010-9 pron private me sipërfaqe 1228 m2 posedim individual 1/1 te vendi i quajtur Udha e Lugut fshati: Gllavic- Rashincë Komuna Shtime. /Poljoprivredna parcela (njiva 4 klase) katastarska jedinica sa parcelom broj P-72809072-01010-9 privatna svojina sa površinom od 1228 m2 individualna svojina 1/1 na mestu zvanom Lugski put, selo Glavic-Rašinka, opština Štimlje.

2.Parcellë tokë Bujqësore (Arë e klasës 4)Njesia kadastrale me me numer parcelle P-72809072-01010-19 pron private me sipërfaqe 101m2 posedim 1/1 te vendi i quajtur Udha e Lugut fshati Gllavic- Rashincë Komuna Shtime./ Poljoprivredna parcela zemljišta (njiva 4 klase) katastarska jedinica sa parcelom broj P-72809072-01010-19 privatna svojina površine 101m2, posedovanje 1/1 zemljišta pod nazivom Lugski put, selo Glavic-Rašinka, opština Štimlje

3.Parcellë tokë Bujqësore (Arëe klasës 4)Njesia kadastrale me me numer parcelle P-72809072-01010-18 pron private me sipërfaqe 1607m2 posedim 1/8 te vendi i quajtur Udha e Lugut fshati Gllavic- Rashincë Komuna Shtime. /Poljoprivredna parcela (njiva 4 klase) katastarska jedinica sa parcelom broj P-72809072-01010-18 privatna svojina površine 1607m2, posedovanje 1/8 zemljišta pod nazivom Lugski put, selo Glavic-Rašinka, opština Štimlje.

Çmimi fillestarë/Početna cena:

Çmimi fillestarë për parcelen: P-72809072-01010-9 është 700€ për një ari / Početna cena parcele: P-72809072-01010-9 je 700€ za jedan ar

Çmimi fillestarë për parcelen: P-72809072-01010-19 është 700€ për një ari / Početna cena parcele: P-72809072-01010-19 je 700€ za jedan ar

Çmimi fillestarë për Parcelen: P-72809072-01010-18 është 700€ për një ari/ Početna cena parcele: P-72809072-01010-18 je 700€ za jedan ar

Kushtet e pjesëmarrjes: Kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancioni bankar) në shumën 10%(minimumi) të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.

Uslov učesća na aukciji: kada prodajemo nepokretnosti, je akontacija (bankarska garancija) u iznosu od 10% neizmirenih poreskih obaveza poreskog obveznika.

Paraqitja e Ofertave: Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

Dostavljanje ponuda: Sve ponude moraju jasno da identifikuju ponudenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu i broj bankovnog računa fizičkog ili pravnog lica koje podnosi ponudu. Ponude moraju biti primljene u zatvorenoj kovrti pre navedenog datuma i gorepomenutog roka.

Kushtet e pagesës, Kërkohe pagese e tërësishme dhe e menjëhershme.

Pasuria mund të inspektohet: nga data 03.07.2023 deri me datën 10.07.2023 nga ora 09 deri 15 Nekretnina se moze razgledati: od datum 03.07.2023 do 10.07.2023 od 09 do 15 sati

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit të mbledhjes/Ime, prezime i službenik naplate: ISLAM HAD

Data / Date / Datum: 30.06.2023



Prishtinë, 29.06.2023

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Energy Development Group - Kosova“ L.L.C., me numër Unik Identifikues 810862179 me adresë: Rruga Madanaj, pn Gjakova, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 19.05.2023 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 6 MW ZK Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Energy Development Group - Kosova“ L.L.C., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 6 MW ZK Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.22/7707/ dt.03.02.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturas;
- Vendimin për Leje Ndërtimi për “Ndërtimin Ngritjen e Impiantit Fotovoltaik (Parkut Solar) për prodhimin e energjisë elektrike prej 6 MW ZK – Kodra e Hutit Komuna e Gjakovës” nr. 07/351/02-28581/2022 dt. 16.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës;
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 3594 dt.02.05.2023 të lëshuar nga KEDS SH.A.;
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratrat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën;
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar;
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar kërkesën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: leke.sahatciu@gmail.com dhe LEGAL-LEECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshepte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

